

VENDIM
Nr. 424, datë 23.7.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 893, DATË 27.12.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT ‘EKIPET SPORTIVE NË SHKOLLA’, NË KUADËR TË LËVIZJES OLIMPIKE SHQIPTARE, DHE PËR AKTIVITETE NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË SPORTEVE TË KOMITETIT OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR (KOKSH)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, pika 1, dhe 15, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 893, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e projektit “Ekipet sportive në shkolla”, në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare, dhe për aktivitete në kuadër të ndërkombëtarizimit të sporteve të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH)”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Financimin, në masën 1 058 000 000 (një miliard e pesëdhjetë e tetë milionë) lekë, të projektit “Ekipet sportive në shkolla”, në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), dhe financimin, në masën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë, të projektit “Ekipet sportive në shkolla”, në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), dhe për aktivitete në kuadër të ndërkombëtarizimit të sporteve, të ndara, si më poshtë vijon:

- a) 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2022;
- b) 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2023;
- c) 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2024;
- ç) 200 000 000 (dyqind milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2024, për projektin “Ekipet sportive në shkolla”, dhe për aktivitete në kuadër të ndërkombëtarizimit të sporteve;
- d) 308 000 000 (treqind e tetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2025, për projektin “Ekipet sportive në shkolla”, nga të cilat 298 000 000 (dyqind e nëntëdhjetë e tetë milionë) lekë për projektin “Ekipet sportive në shkolla”, dhe 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për shahun, pjesë e të njëjtit projekt.”.

b) Në pikën 2, fjalët “... si dhe buxheti i miratuar për vitin 2024 ...” zëvendësohen me “... buxheti i miratuar për vitin 2024, si dhe buxheti i miratuar për vitin 2025 ...”.

c) Në pikën 3, fjalët “... si dhe brenda muajit shkurt 2025, përkatësisht për financimet sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”...” zëvendësohen me “... dhe brenda muajit shkurt 2025, si edhe brenda muajit gusht 2025, përkatësisht për financimet sipas shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”...”.

ç) Në fjalinë e dytë, të pikës 4, togfjalëshi “... muajit shkurt 2025 ...” zëvendësohet me “... muajit gusht 2025 ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyjnë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku